

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6448
E hënë, 25 tetor 2021
çmimi 0.40

Kupchan: Ballkani të përgatitet për rikthim të angazhimit intensiv amerikan

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ), DREJT SHPALLJES SË REZULTATIT PËRFUNDIMTAR TË ZGJEDHJEVE LOKALE TË 17 TETORIT

BRENDA PAK DITËSH KQZ-ja SHPALL REZULTATIN PËRFUNDIMTAR TË ZGJEDHJEVE



Brenda pak ditësh Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) do ta shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve lokale të 17 tetorit. Zëdhënësi i këtij institucioni, Valmir Elezi, ka treguar se ky rezultat do të shpallet pasi të numërohen edhe votat me kusht dhe ato të personave me nevoja të veçanta. Në Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve (QNR) të dielën ka nisur numërimi i votave të ardhura nga jashtë përmes postës, kurse votat me kusht dhe ato të personave me nevoja të veçanta do të numërohen të hënën

SAZAN IBRAHIMI: SËRISH DO TA KËRKOJMË HEQJEN E ORËS POLICORE

FAQE 7



KURTI TAKON POLICËT E LËNDUAR GJATË AKSIONIT NË VERI: GRUPET KRIMINALE S'DO TË TOLEROHEN

FAQE 3

AKTUALE



KOLUMBIA ARRESTON TRAFIKANTIN MË TË KËRKUAR TË DROGËS

F. 2

MASAT E REJA, ZGJATJET ORARI I LËVIZJES SË QYTETARËVE DHE GASTRONOMISË

F. 6

GJERMANIA HEQ KOSOVËN NGA LISTA E VENDEVE TË RREZIKSHME SA I PËRKET COVID-19

F. 3

EKONOMI



QYTETARËT S'KANË ALTERNATIVË, E PËRDORIN ENERGJINË ELEKTRIKE PËR NGROHJE

F. 8

SPORT

BALLKANI MPOSHTI NË DERBI PRISHTINËN, DRENICA NUK GABON NDAJ DUKAGJINIT

F.10



EKIPI I BOKSIT TË KOSOVËS NUK LEJOHET AËS HERËN E TRETË TË HYJË NË SERBI

F.10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhep isht
Tetov⁹
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 0
+389 44 487 795
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
ND, RTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji biznesi.com
info@kolegji biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOV.
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kolumbia arreston trafikantin më të kërkuar të drogës

BOGOTA, 24 TETOR - Trafikanti më i kërkuar i drogës në Kolombi dhe udhëheqësi i bandës më të madhe kriminale në këtë shtet është arrestuar.

Dairo Antonio Usuga, i njohur si Otoniel, është kapur të shtunën gjatë një operacioni të përbashkët të ushtrisë, forcave ajrore dhe policisë. Qeveria kishte ofruar 800 000 dollarë shpërblim për informacionet rreth vendndodhjes së tij, ndërkaq Shtetet e Bashkuara kishin ofruar pesë milionë dollarë për kokën e tij.

Presidenti i Kolumbisë, Ivan Duque, përmes një mesazhi televiziv, lavdëroi autoritetet për kapjen e Otonielit. "Kjo është goditja më e madhe kundër trafikimit të drogës në shtetin tonë në këtë shekull. Kjo goditje mund

të krahasohet vetëm me rënien e Pablo Escobarit në vitet '90", tha ai, raporton "BBC".

Otoniel u kap në provincën Antioquia në veriperëndim të Kolumbisë, që gjendet pranë kufirit me Panamanë. Ai kishte përdorur një rjet të shtëpive të sigurta për të lëvizur dhe për ta shmangur arrestimin. Sipas autoriteteve, ai nuk kishte përdorur telefon celular, por kishte përdorur korrierët e tij për të komunikuar. Megjithatë, sipas gazetës "El Tiempo", vendndodhja e tij u zbulua rreth dy javë më parë.

Në operacionin për kapjen e tij u përfshin 500 ushtarë, të mbështetur nga 22 helikopterë. Një zyrtar policor u vra gjatë këtij operacioni.

Sipas shefit të policisë, Jorge Vargas, lëvizjet e tij ishin gjurmuar përmes

imazheve satelitore. Agjencitë e Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara kishin qenë të përfshira në operacionin për gjetjen e Otonielit.

Otoniel, 50 vjeç, u bë kreu i Klanit të Gjirit, që më herët njihej me emrin Klani Usuga, pasi udhëheqësi i mëparshëm, vëllai i tij, u vra nga policia gjatë një bastisjeje gati dhjetë vjet më parë.

Autoritetet kolumbiane e cilësojnë këtë bandë si organizatën më të fuqishme kriminale në shtet, ndërkaq autoritetet në ShBA e kanë përshkruar atë si një organizatë "e armatosur rëndë dhe shumë e dhunshme".

Banda, që operon në shumë provinca, ka shumë lidhje ndërkombëtare dhe është e përfshirë në kontrabandën e drogës dhe njerëzve, nxjerrjen e



paligjshme të arit dhe zhvatje. Banda e Otonielit kontrollon shumë rrugë që përdoren për trafikimin e drogës nga Kolumbia për në SHBA, por edhe në shtete të tjera, përfshirë edhe Rusinë. Otoniel tani përballet me një sërë

akuzash, përfshirë edhe trafikimin e kokainës në ShBA, vrasjen e zyrtarëve policorë dhe rekrutimin e fëmijëve.

Ndaj tij ShBA-ja kishte ngritur akuza më 2009 dhe ai përballet me mundësinë e ekstradimit.

Britania regjistron numrin më të lartë të rasteve me Covid që prej korrikut



LONDËR, 24 TETOR - Britania ka regjistruar këtë javë numrin më të lartë të rasteve të reja me Covid-19 që prej korrikut, thuhet në të dhënat e qeverisë. Në Britani 333 465 persona kanë rezultuar pozitivë gjatë shtatë ditëve të fundit, apo rreth 15 për qind më shumë se javën paraprake. Ky është numri më i lartë i rasteve të reja brenda një jave që prej 21 korrikut.

Po ashtu, në shtatëditëshin e fundit vdekjet janë rritur për 12 për qind, duke e çuar në 139 878 numrin e rasteve me fatalitet që prej nisjes së pandemisë. Britania është vendi i dytë në

Evropë, pas Rusisë, me numrin më të lartë të vdekjeve, sipas të dhënave të paraqitura nga Universiteti "Johns Hopkins". Shkencëtarët kryesorë e kanë këshilluar Britaninë që të rivendosi masa kundër Covid-19, përfshirë edhe mbajtjen e detyrueshme të maskave, certifikatat e vaksinave dhe rekomandimeve që njerëzit të punojnë nga shtëpia.

Grupi këshillues i shkencëtarëve për emergjencën ka paralajmëruar për "rritje të shpejtë të mundshme të shtrimeve në spital" teksa rastet me koronavirus po vazhdojnë të

rriten.

Kryeministri i Britanisë, Boris Johnson, e ka minimizuar mundësinë e rikthimit të masës izoluese.

Ndërkaq, Rusia për të pestën ditë me radhë ka regjistruar numër rekord të vdekjeve dhe autoritetet janë përgatitur që t'i mbyllin vendet e punës dhe kanë vendosur masën e izolimit në kryeqytet.

Më 23 tetor, Rusia regjistroi 1 075 vdekje dhe 37 678 raste të reja me koronavirus. Ky shtet ka një prej niveleve më të ulëta të vaksinimit kundër koronavirusit në Evropë.

ShBA-ja heq vizat për kroatët

WASHINGTON, 24 TETOR - Nga 23 tetori qytetarët kroatë mund të udhëtojnë në Shtetet e Bashkuara pa viza, njoftoi Ambasada Amerikane në Zagreb. "Erdhi edhe kjo ditë. Urime Kroaci për anëtarësimin zyrtar në Programin e Heqjes së Vizave", tha Ambasada e ShBA-së në Kroaci në faqen e saj zyrtare në "Facebook".

Ky vendim i Sistemit Elektronik për Autorizim të Udhëtimeve (ESTA) vlen për qytetarët kroatë që duan ta vizitojnë ShBA-në për turizëm ose biznes dhe mund të qëndrojnë atje jo më shumë se 90 ditë.

Anëtarësimi i Kroacisë në të ashtuquajturin Program për Heqjen e Vizave (VWP) është një hap i rëndësishëm për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ekonomik dhe në fushën e sigurisë

midis dy shteteve, tha Ambasada Amerikane në Zagreb. "Ne jemi jashtëzakonisht të kënaqur që qytetarët kroatë tani e gëzojnë mundësinë e udhëtimit në ShBA pa viza. Ky ka qenë një proces i gjatë, por i rëndësishëm dhe ne mirëpresim përpjekjet e qeverisë kroate për t'i përmbyshur kriteret e ashpra të programit tonë", tha Mark Fleming, i ngarkuari me punë në Ambasadën e ShBA-së në Zagreb. Programi për Heqjen e Vizave është një partneritet gjithëpërfshirës i sigurisë midis ShBA-së dhe shteteve pjesëmarrëse, që lejon udhëtimin në ShBA për qëllime turizmi apo biznesi deri në 90 ditë, duke mbrojtur sigurinë kombëtare amerikane.

Që një shtet të bëhet pjesë e këtij programi, i njëjti duhet të

përmbyshë kriteret në fushën e kundërterrorizmit, atë të zbatimit të ligjit, të migracionit, sigurisë së dokumenteve dhe menaxhimit të kufijve, thuhet në deklaratë.

Ambasada, po ashtu, tha se kërkesë për t'u bërë pjesë e këtij programi është që aplikimet e refuzuara për viza duhet të jetë nën 3 për qind. Këtë kriter Kroacia e ka përmbyshur së fundmi. Autorizimet për udhëtime që qytetarët marrin nga ESTA zakonisht vlejnë për dy vjet. Udhëtarët me vizat e lëshuara B1/B2 tashmë mund t'i përdorin ato për të udhëtuar në ShBA.

Në përgjithësi janë vetëm tri anëtare të Bashkimit Evropian - Rumania, Bullgaria dhe Qiproja që ShBA-ja ende nuk ua ka hequr vizat.



Kurti takon policët e lënduar gjatë aksionit në veri: Grupet kriminale s'do të tolerohen

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 TETOR - Kryeministri Albin Kurti dhe ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, kanë pritur të dielën në takim zyrtarë policorë që kanë pësuar lëndime trupore më 13 tetor, gjatë operacionit policor për parandalimin dhe luftimin e kontrabandës në Mitrovicë të Veriut dhe disa rajone të Kosovës.

Në takimin me drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti dhe zyrtarë policorë, u bisedua lidhur me operacionin policor të zbatuar në bashkëpunim me Doganën e Kosovës, nën autorizimin e prokurorive kompetente.

Operacioni policor, i realizuar në

rajonin e Prishtinës, Pejës, Mitrovicës së Jugut dhe Mitrovicës së Veriut, kaloi pa probleme, përveç në Mitrovicën e Veriut, ku grupe kriminale përdorën bombola gazi, shokbomba, të shtëna me armë zjarri e granata dore, me qëllim të pengimit dhe sulmit ndaj zyrtarëve policorë dhe doganorë, të cilët ishin në kryerje të detyrës zyrtare.

Si pasojë e gjuajtjeve me mjete të ndryshme vdekjeprurëse drejt zyrtarëve policorë, dhjetë zyrtarë policorë kishin pësuar lëndime trupore, prej tyre shtatë zyrtarë të nacionalitetit shqiptar dhe tre zyrtarë të nacionalitetit serb.

Kurti shprehu keqardhjen për sulmin ndaj Policisë së Kosovës, duke thënë se krimi dhe grupet kriminale nuk do të tolerohen



dhe do të luftohen sikurse do të luftohet dhe parandalohet kontrabanda.

U vlerësua mbarëvajtja e operacionit policor që kishte për qëllim parandalimin dhe luftimin e kontrabandës në disa

rajone të Kosovës si dhe u vlerësuan veprimet profesionale të zyrtarëve policorë realizuar në bashkëpunim me Doganën e Kosovës dhe organet e drejtësisë. Gjatë takimit u tha se Policia e Kosovës do ta vazhdojë

realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të saj në nivel vendi me qëllim të parandalimit të veprimtarive kriminale, parandalimit të kontrabandës së mallrave si dhe shkatërrimit të grupeve kriminale.

Gjermania heq Kosovën nga lista e vendeve me rrezik sa i përket Covid-19



PRISHTINË, 24 TETOR - Instituti "Robert Koch" ka hartuar listën më të re të vendeve të rrezikuara nga virusi Covid-19. Nga kjo listë prej të dielës janë hequr Kosova, Iraku, Hondurasi dhe Kenia. Ndërsa si vende të rrezikuara janë shpallur Kroacia, Bullgaria, Kameruni, Kongo dhe Singapori. E nga vendet Bashkimit Evropian në këtë listë janë edhe Rumania dhe Sllovenia. Gjendja në Bullgari dhe Kroaci është rënduar shumë së fundi.

Prej të dielës udhëtarët që nisen nga Kosova për Gjermani nuk kanë më nevojë për teste dhe karantinim. Teste duhet të kenë vetëm udhëtarët me avion të cilët nuk janë vaksinuar apo

shëruar nga Covid-19 në gjashtë muajt e fundit.

Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Serbia edhe më tej mbeten në listën e vendeve të rrezikuara për shkak të shifrave më të larta të infektiveve me virusin korona. Udhëtarët nga këto vende duhet të kenë një test me vete (nëse nuk janë vaksinuar apo shëruar nga Covid-19 në gjashtë muajt e fundit), e ata që nuk janë vaksinuar apo shëruar duhet të futen edhe në karantinë dhjetë ditë në Gjermani.

Karantinimi mund të shkurtrohet pas pesë ditësh nëse bëhet një test dhe rezultati i testit është negativ. /DW/

Konfiskohet drogë në Suharekë, policia në kërkim të dyshuarit

SUHAREKË, 24 TETOR - Policia e Kosovës, konkretisht Drejtoria për Hetimin dhe Luftimin e Narkotikëve - Njësia në Prizren dhe Njësia e Ferizajt gjatë një pune operative dhe marrjes së informatave nga burime relevante, me urdhër verbal të prokurorit të shtetit dhe aprovimin e gjyqarit të procedurës paraprake, ka realizuar një bastisje në shtëpinë dhe objektet përcjellëse të të dyshuarit me iniciale (K. B.) në fshatin Sallagrazhd, komuna e Suharekës, me dyshimin se në shtëpinë e tij gjendet një sasi e substancave narkotike e llojit marijuanë. "Asistim në këtë operacion kanë ofruar edhe Njësitet për Reagim të Shpejtë

(NJRSh), patrullat policore të Stacionit Policor në Suharekë si dhe forenzika rajonale. Sipas detyrës zyrtare, janë ftuar edhe dy avokatë mbrojtës", thuhet në njoftimin për media.

Policia ka njoftuar se gjatë bastisjes janë gjetur dhe sekuestruar dëshmitë/provat si në vijim: një thes najloni i zi me substancë të dyshuar narkotike e llojit marijuanë, i cili, pas matjes, rezulton me peshë pesë kg; një thes najloni i zi me substancë të dyshuar narkotike e llojit marijuanë, i cili, pas matjes, rezulton me peshë pesë kg; një thes najloni i zi me substancë të dyshuar narkotike e llojit marijuanë, i cili, pas matjes, rezulton me peshë 400 gramë, një peshore elektrike



ngjyrë e bardhë, tri role plastike që shërbejnë për paketim të substancës narkotike dhe një aparat elektronik për shërbim të vakumimit të qeseve plastike - paketim të marijuanës. "Njësitet relevante policore janë duke zhvilluar hetime lidhur me rastin dhe po punojnë me intensitet të madh për arrestimin e personit të dyshuar që ndodhet në arrati. Policia e Kosovës është e përkushtuar për parandalimin dhe luftimin e veprave penale në përgjithësi, veçanërisht masa rigoroze ligjore do të aplikohen ndaj personave të përfshirë në përdorim shitje apo abuzim të substancave narkotike", thuhet në njoftimin për media.



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ), DREJT SHPALLJES SË REZULTATIT PËRFUNDIMTAR TË ZGJEDHJEVE LOKALE TË 17 TETORIT

Brenda pak ditësh KQZ-ja shpall rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve

Brenda pak ditësh Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) do ta shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve lokale të 17 tetorit. Zëdhënësi i këtij institucioni, Valmir Elezi, ka treguar se ky rezultat do të shpallet pasi të numërohen edhe votat me kusht dhe ato të personave me nevoja të veçanta. Në Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve (QNR) të dielën ka nisur numërimi i votave të ardhura nga jashtë përmes postës, kurse votat me kusht dhe ato të personave me nevoja të veçanta do të numërohen të hënën

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

Prishtinën, 24 tetor - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) pritet t'i shpallë rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve lokale të 17 tetorit brenda pak ditësh.

Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka treguar të dielën se pas numërimit të votave me kusht, atyre të personave me nevoja të veçanta që do të bëhet të hënën, dhe pas konfirmimit nga PZAP-i e Gjykata Supreme, do të bëhet shpallja e rezultateve

përfundimtare. "KQZ-ja do t'i shpallë rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve për kryetarë të komunave pasi të numërohen edhe votat me kusht dhe ato të personave me nevoja të veçanta që, sipas planifikimit tonë, do të numërohen të hënën, si dhe pasi t'i marrim konfirmimet nga PZAP-i dhe Gjykata Supreme", ka thënë Elezi në një konferencë për media.

Ai ka bërë me dije se në vitin 2017 KQZ-së i janë dashur nëntë ditë për t'i shpallur rezultatet përfundimtare të raundit të parë të zgjedhjeve për kryetarë të

komunave dhe tri ditë të tjera për t'i certifikuar ato.

Në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) të dielën ka nisur numërimi i votave të ardhura nga jashtë përmes postës. Elezi ka thënë se gjatë periudhës 15 shtator - 15 tetor janë pranuar 10 934 zarfe me fletëvotime ku, pas verifikimit, janë aprovuar 9 610 sosh. "Gjatë periudhës së votimit përmes postës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka pranuar rreth 5 700 pakove të supozuara me fletëvotime. Pas vlerësimit dhe verifikimit nga shërbimi votues,

brenda këtyre pakove janë konstatuar 10 934 zarfe të individualizuara me fletëvotime. Gjatë vlerësimit të tyre janë aprovuar 9 610 zarfe të individualizuara me fletëvotime, ndërsa janë refuzuar 1 324 të tilla pasi nuk janë në përputhje me kriteret ligjore", ka deklaruar Elezi, duke treguar arsyen e refuzimit të këtyre fletëvotimeve. "Më shumë se gjysma e tyre, 614, janë refuzuar pasi janë dërguar nga persona që nuk kanë aplikuar për regjistrim si votues jashtë Kosovës, kurse 200 janë dërguar nga persona që nuk kanë arritur të regjistrohen si votues. Ka edhe raste kur pakoja me fletëvotime është dërguar më shumë se një herë nga persona të njëjtë e që janë 168", ka thënë Elezi. Sa iu përket votave me kusht, Elezi ka deklaruar se ato do të numërohen të hënën dhe pas përfundimit të numërimit të tyre pritet certifikimi i zgjedhjeve.

Do të hetohen 10 për qind të vendvotimeve të çdo komune

Zëdhënësi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valmir Elezi, ka thënë se të dielën ka nisur edhe hetimi i 10 për qind të vendvotimeve të çdo komune të cilat u takojnë zgjedhjeve për kuvende komunale. Ai ka treguar arsyen e hetimit të 255 vendvotimeve. "Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të hetojë 10 për qind të vendvotimeve të çdo komune dhe që u takojnë zgjedhjeve për kuvende komunale. Këto vendvotime që do të hetohen, e që në total janë 255 vendvotime, janë përzgjedhur rastësisht dhe që gjatë pranimit të materialit të tyre nuk është vërejtur ndonjë parregullsi. Hetimi i tyre ka për qëllim që të vërtetojë nëse këshilli i vendvotimit ka bartur

→ në mënyrë të saktë rezultatin/votat nga fleta llogaritëse e kandidatëve në formularin e rezultatit të kandidatëve. Fleta llogaritëse e kandidatëve është një fletë pune ku regjistrohen votat e kandidatëve gjatë numërimit para se ato të barten në formularin e rezultatit të kandidatëve”, ka thënë Elezi. Sipas procedurës, nëse nga hetimi rezulton se ka ndryshime dhe votat nuk janë bartur në mënyrë të saktë atëherë, pas vendimit të KQZ-së, do të hapet kutia e votimit për ta saktësuar gjendjen. Sipas rezultateve preliminare të shpallura nga komisioni qendror i zgjedhjeve, nga 38 komunat ku janë zhvilluar zgjedhjet, në 16

komuna janë shënuar fitore të partive dhe 21 komuna do të shkojnë në raundin e dytë të zgjedhjeve lokale në Kosovë i cili do të mbahet më 14 nëntor.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia ka anuluar rezultatet për kryetar komune në Han të Elezit dhe ka urdhëruar që në këtë komunë të përsëritet votimi.

Bazuar në rezultatet preliminare të KQZ-së, Lista Serbe ka fituar nëntë komuna, Partia Demokratike e Kosovës ka fituar katër komuna, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Lidhja Demokratike e Kosovës nga dy komuna, kurse Lëvizja Vetëvendosje nuk ka arritur të fitojë asnjë komunë në raundin e parë.

AKR-ja kërkon rinumërim të plotë të votave në Prishtinë

Gëzim Mehmeti, kandidati i Aleancës Kosova e Re për kryetar të Prishtinës, ka kërkuar rinumërim të plotë të votave në këtë komunë. Në një konferencë për media ai ka deklaruar se këto zgjedhje janë manipuluar nga individë dhe subjekte të tjera politike, por nuk ka përmendur emra. “Disa individë kanë manipuluar votat, duke u bazuar në të dhënat e publikuara. Në vendvotimin 1926/E01R kemi fakte që janë manipuluar votat. Ka

pasur ndërhyrje në votat e kandidatëve. KQZ duhet ta kthejë besimin te qytetarët. Duhet që e gjithë komuna e Prishtinës të shkojë në rinumërim sepse ka pasur manipulim të votave. Do të parashtrijmë ankesë për këto shkelje. AKR-ja kërkon rinumërim të plotë të 238 vendvotimeve në komunën e Prishtinës. KQZ ka qenë korrekte, por disa individë dhe subjekte të tjera kanë pasur qëllim ta dëmtojnë AKR-në.

Nuk kemi pasur mjaftueshëm komisionarë, për këtë edhe kanë ndodhur manipulimet. Ne jemi dëmtuar në votat për asamble”, ka deklaruar Mehmeti.

Sipas të dhënave paraprake nga KQZ-ja, në 205 vendvotime të numëruara nga 238 sa janë gjithsej në kryeqytet, AKR-ja ka marrë 3 714 vota për kuvend komunal, ndërsa me numërimin e 100 për qind të votave për kryetar, Mehmeti ka marrë 1 582 vota.

Kupchan: Ballkani të përgatitet për rikthim të angazhimit intensiv amerikan



PRISHTINË, 24 TETOR - Charles Kupchan, ekspert i Këshillit për Marrëdhënie me Jashtë në Shtetet e Bashkuara, ka thënë se rajoni i Ballkanit gjendet në listën e prioritetëve të administratës amerikane. Kupchan, njëherësh profesor në Universitetin Georgetown në Uashington, ka thënë në një intervistë për “Radion Evropa e Lirë”, se Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian duhet t’i bashkojnë forcat për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në rajonin e Ballkanit në mënyrë

që të mbajnë larg ndikimin e Rusisë dhe Kinës. Sipas tij, Christopher Hill, i nominuar i presidentit amerikan Joe Biden për ambasador në Serbi, është njeri me përvojë të jashtëzakonshme në Ballkan dhe nam të madh në Uashington, si dhe me shumë peshë në qarqet diplomatike. BE-ja dhe ShBA-ja janë pajtuar për të forcuar edhe më shumë angazhimin e tyre në Ballkanin Perëndimor, për t’i ndihmuar rajonit që të shënojë përparim në rrugën evropiane. Çfarë

mund të presim nga një përkushtim i tillë, përgjigjet Kupchan: Kritikën nga Parlamenti Evropian nuk janë për t’u befusuar dhe të paarsyeshme. Një kombinim i krizave politike brenda Evropës Perëndimore dhe Shteteve të Bashkuara, plus pandemia, kanë ndikuar që një periudhë të ketë më shumë fokus brenda. Prioritete kanë qenë rimëkëmbja e ekonomisë, luftimi i pandemisë së koronavirusit, kthimi i njerëzve në punë dhe kjo ka bërë që të

ketë më pak vëmendje në agjendën e politikës së jashtme. Sa i përket Evropës, kemi parë një lodhje nga zgjerimi dhe një fokus në Brex-it dhe menaxhim të situatës pas largimit të Britanisë së Madhe nga BE-ja. Ende nuk e kemi tejkaluar pandeminë, ende duhet bërë shumë punë. Mirëpo e vërej që, si në Bruksel, ashtu edhe në Uashington, ka një marrëveshje që për çështjet e papërfunduara në rajonin e Ballkanit. Kjo është kohë e përshtatshme për t’i adresuar ato. Vlen të përmendet

se ajo çfarë po motivon të dyja palët e Atlantikut janë Rusia dhe Kina. Rusia ende përpigjet t’i shfrytëzojë mosmarrëveshjet politike në rajon në të mirë të saj. Kina është duke tentuar të depërtojë në Evropën Juglindore. Prandaj ShBA-ja dhe BE-ja dëshirojnë ta mbajnë Ballkanin Perëndimor larg ndikimit rus dhe atij kinez. Dhe kjo gjë nënkupton zgjidhjen e mosmarrëveshjeve politike dhe drejtimin e të gjitha shteteve të rajonit në rrugë për anëtarësim në BE dhe NATO.”

Masat e reja, zgjatet orari i lëvizjes së qytetarëve dhe puna e gastronomëve

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 24 TETOR - Qeveria e Kosovës më 23 tetor ka miratuar masat e reja kundër pandemisë së koronavirusit. Ndër masat e reja është ndryshimi i orarit të kufizimit të lëvizjes së qytetarëve që do të jetë nga mesnata deri në ora 05:00. Ky kufizim më herët fillonte nga ora 22:00. Po ashtu, bizneseve të gastronomisë u është zgjatur orari i punës deri në orën 23:00. Sa i përket arsimit, sipas masave të reja të marra nga Qeveria e Kosovës, procesi mësimor në institucionet e arsimit parauniversitar në të gjitha nivelet do të zhvillohet me orar të rregullt dhe me prani fizike.

Më herët ekzekutivi kishte lejuar që procesi edukativ në arsimin parauniversitar të bëhej sipas skenarëve dhe me praninë e jo më shumë se 20 nxënësve në një klasë.

Po ashtu, sa i përket numrit të personave që mund të marrin pjesë në ngjarje të zhvilluara në ambiente të jashtme dhe të mbyllura, ka ndryshime në masa. Sipas vendimit të ri, do të lejohen grumbullimet e 70 personave në ambiente të jashtme që marrin pjesë në ngjarje kulturore, ndërkaq në aktivitete që zhvillohen në ambiente të mbyllura do të lejohen 30 persona.

Po ashtu, ceremonitë fetare dhe pritjet për ngushëllim, që mbahen në ambiente të mbyllura, do të lejohen që të marrin pjesë deri në 30 persona, ndërkaq në ambiente të hapura 70 persona, duke respektuar distancën dhe duke mbajtur maskën.

Masat e tjera nuk dallojnë shumë nga ato që janë në fuqi, siç është mbajtja e maskës dhe distancës. Po ashtu, dëshmia përmes certifikatës së vaksinimit apo testeve negative për koronavirus do të kërkohen për hyrje në institucionet shtetërore dhe private, gastronomi, institucione arsimore dhe për hyrje në shtetin e Kosovës.

Qeveria tha se këto masa kanë për qëllim ta parandalojnë shpërndarjen e Covid-19 në tubime, siç janë edhe ato të procesit zgjedhor, ku grumbullohen një numër i madh njerëzish. "Masat për ruajtjen e shëndetit publik dhe mbrojtjen nga Covid-19 janë provuar si jetike për ta kufizuar përhapjen e Covid-19. Sipas raporteve të fundit të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, situata epidemiologjike me Covid-19 në Kosovë është stabile, por rreziku mbetet sepse varianti 'Delta' vazhdon të jetë dominues te ne dhe se në vendet e tjera në rajon dhe botë ka përkeqësim të situatës epidemiologjike", thuhet në arsyetimin e vendimit.



Konfirmohen 13 raste të reja me Covid brenda 24 orëve

Ministria e Shëndetësisë njoftoi të dielën se ka regjistruar 13 raste të reja me koronavirus. Rastet e reja dolën pas testimit të 2 283 mostrave. Prej kësaj shifre, i bie që 0.55 për qind e personave të testuar kanë dalë pozitivë me sëmundjen Covid-19. Në 24-orëshin paraprak, sipas autoriteteve, nuk është regjistruar asnjë viktimitë me koronavirus. Sipas MSh-së, në 24 orët paraprake janë shëruar edhe 21

pacientë, ndërkaq raste aktive me koronavirus janë 456.

Në Kosovë, të shtunën, më 23 tetor, kanë hyrë në fuqi masat e reja kundër pandemisë, ku parashihet ndryshimi i orarit të kufizimit të lëvizjes nga ora 00:00 deri në orën 05:00. Po ashtu, është zgjatur edhe orari i punës së gastronomisë deri në orën 23:00.

Sazan Ibrahimimi: Sërish do ta kërkojmë heqjen e orës policore



PRISHTINË, 24 TETOR - Asociacioni i Komunave të Kosovës sërish do të kërkojë heqjen e orës policore pasi, sipas këtij asociacioni, një masë e tillë është e panevojshme në kohën kur vendi ynë po shënon rënie të numrit të rasteve të reja me koronavirus dhe për disa ditë me radhë nuk ka pasur asnjë rast me fatalitet.

Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Sazan Ibrahimimi, në një intervistë për "KosovaPress", ka thënë se Kosova është ende një nga vendet e rajonit e cila po vazhdon ashpërsimin e masave kundër Covidit. Ai ka thënë se të premtën e kaluar kanë pasur takim me ushtruesen e detyrës së ministres së Shëndetësisë, Dafina Gexha-Bunjaku, ku kanë kërkuar heqjen e orës policore por që, sipas tij, një gjë e tillë nuk ndodhi pasi që ky vendim ishte marrë më herët.

Ibrahimimi thotë se Asociacioni i Komunave të Kosovës sërish do ta kërkojë heqjen e orës policore pasi, sipas tij, një masë e tillë është e panevojshme. "Ne

përsëri do të kërkojmë që ora policore të largohet dhe bartja e maskës të mos jetë obligative në rastin kur je duke ecur vetëm, dhe duke e marrë parasysh që gastronomia do të mbyllet në orën 23:00. Nuk ka kurrfarë logjike nëse gastronomia mbyllet në orën 23:00 dhe ne të kemi orë policore, sepse kush do të frekuentojë nëpër lokale pas orës 23:00 kur të gjitha lokalitetet janë të mbyllura? Masat duhet të ndërmerren edhe në bazë të përvojës së ndryshme në shtetet e rajonit dhe në Evropë. Qytetari i Kosovës ka qenë shumë i disiplinuar. Kemi mbi 50 % të qytetarëve të Republikës së Kosovës të cilët i janë përgjigjur pozitivisht procesit të vaksinimit dhe një ndër masat pothuajse kryesore për mbrojtjen nga bartja e virusit Covid dhe përsëri edhe kryetarët e komunave shtojnë edhe pjesën tjetër të qytetarëve që t'i përgjigjen pozitivisht procesit të vaksinimit në mënyrë që të mos kemi humbje të jetës së qytetarit", ka thënë Ibrahimimi.

Qytetarët, s'kanë alternativë, e përdorin energjinë elektrike për ngrohje



PRISHTINË, 24 TETOR - Albert Ahmeti jeton në lagjen e Spitalit në Prishtinë. Ai dhe bashkëshortja e tij kanë një fëmijë katërmuajsh. Për dallim prej viteve të kaluara, këtë vit familja Ahmeti thotë se do të jetë e obliguar të shpenzojë më shumë energji elektrike për ta ngrohur banesën në të cilën jetojnë. Burrë dhe grua nuk ka alternativë tjetër përpos ngrohjes me energji elektrike. "Jetoj në një banesë përafërsisht 70 metra katrorë dhe atë e ngrohim me energji elektrike. E kemi një vajzë të vogël katërmuajshe tash dhe sigurisht është e domosdoshme ngrohja për tërë banesën në mënyrë që të mos ftohet lehtë, pasi për fëmijë është shumë më problematike sezoni i dimrit", ka thënë Ahmeti për "Radion Evropa e Lirë". Ai ka theksuar se vitin e kaluar gjatë sezonit të dimrit ka paguar mesatarisht 100 euro në muaj për energjinë e shpenzuar për ngrohje të banesës dhe ujit si dhe punë të tjera të shtëpisë.

Këtë vit shpreson të mos paguajë më shumë dhe thotë të jetë i shqetësuar nga paralajmërimi se mund të ketë rritje të çmimit të energjisë elektrike në muajt në vijim. "Rritja e çmimit të energjisë elektrike është e papranueshme në këtë kohë duke e ditur se janë rritur dhe çmimet e produkteve ushqimore, pra produkteve bazë, në anën tjetër nuk ka ndonjë lëvizje të pagave në të gjitha sektorët në Kosovë", ka thënë Ahmeti.

Njëjtë si Ahmeti në Kosovë vepron një numër i madh i qytetarëve.

Në mungesë të sistemeve të ngrohjes qendrore, në qytete dhe fshatra kryesisht ngrohja e shtëpive bëhet përmes djegies së drurit dhe qymyrit si dhe përmes energjisë elektrike.

Bazuar në statistikat e institucioneve, amvisëritë janë shpenzueset kryesore të energjisë që prodhohet në Kosovë.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, 28 për qind e sasisë së përgjithshme të energjisë elektrike është konsumuar nga amvisëritë gjatë vitit 2020. Kjo sasi kryesisht është shpenzuar për ngrohje të shtëpive, hapësirave të tjera, ngrohje të ujit si dhe në

kuzhina.

Aktualisht çmimi i energjisë elektrike në vendet e Bashkimit Evropian është rritur për disa herë. Të njëjtën situatë mund ta përjetojë edhe Kosova brenda pak muajsh dhe për këtë ka paralajmëruar ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, e cila ka lutur qytetarët që të mos përdorin energjinë elektrike për të ngrohur shtëpitë gjatë sezonit të dimrit. "Qytetarët duhet të kenë parasysh që të mos ngrohen me energji elektrike. Sa më shumë që konsumojmë do të rritet importi, e kjo do të ndikojë në çmimet në vitin tjetër gjatë sezonit të dimrit", ka deklaruar më 20 tetor ministrja Rizvanolli në një debat të organizuar nga Lëvizja FOL.

Në shtetet e Bashkimit Evropian, sipas Agjencisë Evropiane të Statistikave (Eurostat), konsumi kryesor i energjisë është nga amvisëritë me qëllim të ngrohjes së hapësirave me rreth 64 për qind, 14 për qind e energjisë elektrike shpenzohet për ndriçim dhe pajisje të tjera elektrike, rreth 15 për qind për ngrohje të ujit, 6 për qind në kuzhina, ndërsa pjesa mbetur për ngrohje dhe qëllime të tjera.

Ngrohtoret mbulojnë vetëm 3 për qind të kërkesës

Kosova, me rreth 2 milionë banorë, ka vetëm katër ngrohtore qendrore: "Termokosi"-n në Prishtinë, ngrohtoren e qytetit në Gjakovë, "Termomit" në Mitrovicën Veriore si dhe ngrohtoren në Zveçan. Por, funksionale dhe që mbulojnë numër më të madh të shtëpive dhe objekteve janë vetëm dy: "Termokosi" në Prishtinë si dhe ngrohtorja e qytetit në Gjakovë. "Termokosi" ka rreth 15 mijë konsumatorë, ndërsa ngrohtorja e qytetit në Gjakovë ka rreth 2 000.

Në Mitrovicën Veriore dhe Zveçan ngrohtoret janë tejet të vjetruara. Edhe në kohën sa kanë funksionuar kanë pasur kapacitete të kufizuara.

Sistemet e ngrohjes qendrore nëpër qytetet e Kosovës mbulojnë shumë pak territor. Sipas Strategjisë së Kosovës për ngrohje,

kapacitetet që kanë këto ngrohtore mbulojnë vetëm 3 për qind të kërkesës së përgjithshme për ngrohje në Kosovë.

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, mbi 600 mijë qytetarë të Kosovës jetojnë në zona urbane, të tjerët në zona rurale. Ata që jetojnë në zona urbane, kryesisht në banesa kolektive, nuk kanë alternativë tjetër të ngrohjes përpos me energji elektrike.

Pa izolime dhe pa pajisje efçiente

Trimor Gjokokaj është inxhinier i ndërtimit si dhe auditor i energjisë efçiente. Ai ka thënë se për qindja e madhe e energjisë elektrike që shpenzohet për t'i ngrohur shtëpitë është për shkak se numri më i madh i shtëpive janë ndërtuar pas përfundimit të luftës së vitit 1998-99.

Nevoja e madhe e qytetarëve për të pasur strehim pas shkatërrimit, sipas tij, ka bërë që të ndërtohen qindra-mijëra shtëpi pa kritere dhe me materiale të dobëta. Këto shtëpi edhe sot, sipas Gjokokajt, janë humbëset më të mëdha të energjisë. "Janë bërë ndërtime të shpejta dhe ka ardhur deri tek ideja që të përfundohet sa më shpejt. Nuk janë shikuar materialet izoluese, nuk janë analizuar pozicionet e caktuara të izolimeve dhe për fasadën e jashtme në fillim as që është diktuar", ka deklaruar Gjokokaj.

Gjokokaj ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se për dallim prej vendeve evropiane, efçienca e energjisë si term ka nisur të diskutohet vetëm vitet e fundit në Kosovë. Ndërtimi i shtëpive dhe objekteve të banimit, sipas tij, në të kaluarën është bërë pa ndonjë analizë për rritje të efçiensës së energjisë. "Nuk kemi pasur investime në sisteme të ngrohjes. Gjithçka ka qenë sa më e thjeshtë, sa më e lirë, por që shpenzimet e energjisë elektrike kanë qenë të mëdha si te ndriçimi si te ngrohja e ambientit e, po ashtu, edhe te ngrohja e ujit për sanitari dhe këto janë defektet e humbjeve të mëdha të energjisë", është shprehur Gjokokaj. Ai ka theksuar se kostoja e izolimeve për ta rritur

efçiençën e energjisë si dhe investimit në pajisje efçiente është i lartë në raport me standardin e qytetarëve në Kosovë.

Pajisjet efçiente, të shtrenjta për t'i blerë

Rinora Gojani nga Balkan Green Foundation thotë se qytetarët në Kosovë do të duhej të kishin lehtësira kur investojnë në pajisje efçiente. Ajo sugjeron që qeveria të krijojë programe përmes të cilave qytetarët do të mbështeten në investime që rritin efçiençën e energjisë. "Qeveria e Kosovës duhet të ketë programe, të cilat, ndoshta, vënë akciza për produktet të cilat nuk janë efçiente, ndërsa duhet t'i favorizojë produktet të cilat janë me performancë të mirë të efçiençës së energjisë, pra të cilat konsumojnë më pak energji në mënyrë që edhe për qytetarin më pas të jetë shumë më e lirë dhe më e leverdishme që të investojë në një pajisje e cila është efçiente", ka thënë Gojani, duke shtuar se qeveritë e kaluar kanë pasur në plan që të ndërtojnë një termocentral, me qëllim që t'i mbulojnë nevojat e konsumit të energjisë edhe për ngrohje. "Çfarë ne rekomandojmë është që të shihen alternativat për ngrohje, ndërsa energjia elektrike të përdoret vetëm për konsum tjetër, jo për ngrohje", ka thënë Gojani.

Përkundër disa investimeve në burime alternative të energjisë së ripërtëritshme, rreth 95 për qind e energjisë elektrike në Kosovë prodhohet nga thëngjilli, 2.7 për qind nga hidrocentralet si dhe 2.3 për qind nga era dhe panelet diellore. Sipas ekspertëve, nëse vazhdohet me këtë ritëm, Kosova do ta ketë të vështirë që t'i mbërrijë tragetet e vendosura nga organizatat ndërkombëtare për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme. Sipas Agjencisë Evropiane të Statistikave, me rreth 0.06 centë për kilovat, kosovarët paguajnë më së paku në rajon për energjinë e shpenzuar. Mirëpo, sipas paralajmërimeve të Qeverisë së Kosovës, gjatë sezonit të dimrit të vitit të ardhshëm mund të ketë rritje të çmimit të energjisë elektrike për shkak se rritet konsumi e me të edhe importi i rrymës.



Lidhja e pathyeshme artistike e Gustav Klimt me Egon Schiele

Nga Sophie HAYDOCK

Vienë, 1907. Një artist i ri, me duart e djersitura nga frika i afrohet një artisti më të madh në moshë të veshur me kostum bojëqielli në kopshtin e shtëpisë së tij atelie. Vetëm 17 vjeç, ai i zgjati vizatimet mbi fletët japoneze të zbehta ngjyrë kafe, që shfaqnin torso të gjymtuara, shprehi të shtrembëruara dhe bukuri përhumbëse, njërit prej artistëve kryesorë të Europës. Mori frymë thellë, dhe i bëri pyetjen që e kishte pllakosur, formuar, që kur ishte fëmijë.

“A kam talent?” Çdo gjë, për Egon Schiele-n, varet nga ky moment.

“Talent?”, erdhi përgjigja nga burri që ai adhuronte – Gustav Klimt, atëherë 45 vjeç, themeluesi dhe udhëheqësi i Shkëputjes Veneze – dhe për Schiele-n, një meteor talenti. “Më shumë se ç’duhet”.

I trullosur nga çlirimi, Schiele i propozon një shkëmbim të vizatimeve, duke i ofruar disa fletë të tij për një nga Klimt-i. Përgjigja e Klimt-it? “Pse do që t’i shkëmbesh me mua? Ti vizaton më mirë se unë.”

Dhe me këtë, Egon Schiele mori vulën e praruar të aprovimit nga Gustav Klimt.

Ishte një përplasje krijuese shpirttrash të afërm dhe mendjesh rebele që do të ishte tragjikisht e shkurtër – të dy burrat do të ishin të vdekur për më pak se një dekadë më vonë. Por ndikimi i tyre artistik jehon edhe sot.

Gustav Klimt u lindur i varfër në Baumgarten, afër Vienës, në 1862, i dyti nga shtatë fëmijë – dhe u bë një prej artistëve më të dashur në planet.

Egon Schiele u lind në 1890 dhe u rrit në një qytet të vogël të Tulln, me jo aq larg nga Viena. Babai i tij, një shef stacioni, ishte një burrë i dashur por i rreptë. Në fillim, ishte i impresionuar nga fiksimi i djalit të tij të vogël për të vizatuar trenat që shihnte nga dritarja e shtëpisë pranë stacionit. Por entuziazmi i tij u kthye në dëshpërim kur Schiele ngeli në shkollë dhe refuzoi karrierën për të ndjekur hapat e babait të tij.

Babai i Schiele e dogji nga inati bllokun e skicave të fëmijërisë së Egon-it. Por artisti nuk u frenua. Ai u bë studenti më i ri që pranohej në Akademinë e Arteve të Bukura të Vienës në 1906, njomzak, një gjashtëmbëdhjetëvjeçar. Jo për shumë kohë, Egon-i u nda nga mësuesit e tij konservatorë, dhe u largua në 1909 për të



Danaë, Klimt

themeluar Neukunstgruppe me studentët e tjerë.

Gjatë kësaj kohe Schiele u njoh me Klimt – dhe burri i ri filloi të imitonte mjeshtrin e tij. Por provat e para të Schiele-s ishin për të ardhur keq.

Merr pikturën Danaë, të Klimt, krijuar në 1907. Shih “shiu e artë” që bie mes kofshëve të brishta të gruas, më shprehi të lumtur. Dhe më pas shih përpjekjet adoleshente të Schiele në 1909 – modelja është e struktur në pozicion fetal,

gjunjët nën mjekër, shiu jetësijellës që lan kurrizin e saj. Schiele e kishte humbur thelbin.

Por sidoqoftë, respekti mes dy burrave ishte i ndërsjellë. Schiele pikturoi një autoportret me Klimt-in, The Hermits, në 1912, si homazh të miqësisë së tyre, dhe ishte krenar kur vepra e tij u ekspozua përballë Klimt-it në Berlin, gjatë luftës së parë botërore.

Më pas, në pranverën e 1911,

kur artisti 21-vjeçar, pa para, po kërkonte për modele të lira që të pozonin për veprat e tij të artit provokativ dhe kontroversial, Klimt-i, me bujari e prezantoi burrin e ri me një modele që ai e përdorte vazhdimisht: Wally Neuzil.

Ajo ishte dhurata e madhe që Klimt i bëri Schiele-s.

Wally ishte 17 vjeç atëherë, e lindur në Tattendorf, dhe ishte shpërngulur në Vienë për të fituar jetesën si modele, gjë që, në atë kohë, ishte e ngjashme me prostitucionin. Ishte një shkëndijë flakëruese e një gruaje me sy plot shpirt, një gojë të madhe sensuale dhe flokë të kuqerremtë. Schiele e pikturoi atë përgjatë historisë së tyre të dashurisë 4 vjeçare, dhe ajo u bë pjesë në çdo gjë që ai krijonte.

“Wally, në fillim, ishte thjesht një prej modeleve të Schiele-s”, thotë Jane Kallir, autore e katalogut të Egon Schiele dhe bashkëdrejtore e Galerisë St. Etienne në New York. “Ajo nuk veçohet lehtësisht, apo të zhvillohet në një prani të dukshme në veprën e tij deri në 1912”.

Më pas, tiparet e saj dalluese janë të qarta në vepra si Sleeping Woman (Wally Neuzil), 1912; Wally Neuzil Kneeling with Grey Cloack,

1912; dhe sensuale në *Woman in Underclothes and Stockings* (Wally Neuzil), 1913. Kallir shton: “Ajo që është vërtet e pazakontë është që Schiele i jep [Wally-t] një lëkurë barazie. Jo thjesht si partnerja e tij e jetës, por si partnerja e tij artistike.”

Wally-t i atribuohet transformimi i pjekurisë emocionale të artistit të ri dhe depërtimi që ai u dha modelëve të tij. Kjo dëshmohet te *Portrait of Wally Neuzil*, 1912, krijuar si homologu i *Self-portrait with Physalis*. “Në alegoritë e tij,

Schiele është gjithmonë ylli,” thotë Kallir. “Ai është ‘profeti’, ai me shikimin e dytë. Por në alegoritë nga 1912-14, Wally është krah tij, gjithashtu një ‘profete’ – kjo shkallë njohjeje është vërtet e jashtëzakonshme për atë kohë.”

Me Wally-n, Schiele gjeti zërin e tij. Ai mundi gjithashtu të arrinte mjeshtrin e tij, dhe disa mund të thonë, e tejkaloi atë. Në 1912, ai krijoi veprën kontroverze *Cardinal and Nun* (Caress), bazuar te *The Kiss* qëndrueshmërisht e famshme e Klimt-it. Por Schiele ka një dell

të egër eroticizmi dhe rebelimi që Klimt-i nuk e zotëron.

Por me gjithë forcën dhe bujarinë e Wally-t – ajo qëndroi pranë artistit të turpëruar, pasi Schiele u burgos për 24 ditë i akuzuar për rrëmbim, përdhunim statutor dhe imoralitet publik (dy akuzat e para u rrëzuan shpejt) – ai nuk do të martohej kurrë me të.

Piktura zemërthye *Death and the Maiden* u bë në 1915, si përgjigje e ndarjes së tyre të afërt, para se Schiele të martohej me më të respektueshmen Edith Harms.

Kur Klimt-i vdiq papritur, në moshën 55-vjeçare, në shkurt të 1918 për shkak të epidemisë së gripit spanjoll që përfshiu kontinentin, Schiele ishte i shkatërruar. Ai e vizatoi Klimt-in në shtratin e tij të vdekjes. Ai shkroi për mentorin e tij: “Një artist pabesueshmërisht i arrirë – një burrë me thellësi të rrallë – vepra e tij është një vend i shenjtë”.

Pas vdekjes së Klimt-it, Schiele mori mantelin si figura udhëheqëse e skenës së artit vinez. Por ai nuk do ta dinte që gjithashtu, do të vdiste në fund të

vitet.

Schiele vdiq, në moshën 28-vjeçare, në 31 tetor 1918 – tre ditë pas gruas së tij, Edith Harms, e cila ishte gjashtë muaj shtatzënë me fëmijën e tyre të parë. Dy artistët më të mëdhenj të Austrisë të shuar.

Sot, pak më shumë se 100 vjet nga vdekja e tyre e parakohshme, jehona e tyre mund të ndihet ende. Veprat e Schiele-s mbesin sizmike, transcendentale, tronditëse dhe plot zjarr. Klimt-i do të mbetet përgjithmonë mjeshtri i tij./exlibris.al

Përktheu Enxhi Hudhri



Portrait of Wally Neuzil, 1912, krijuar si homologu i Self-portrait with Physalis

Milot fiton çmimin ‘Skulptori i Vitit’ 2021 në Kiev

Të shtunën 23 tetor në orën 12:00 u janë dhënë disa çmime personaliteteve nga bota e artit në kopshtin e Bibliotekës Oblate, në Firençe për *Celebrity Awards 2021*.

Ceremonia ndërkombëtare, e cila i zhvillua në Kiev mbahet çdo vit shpërblen profesionistë në sektorë të ndryshëm që kanë arritur sukses ose që kanë dhënë kontributin e tyre në zhvillimin e kulturës, artit, muzikës, diplomacisë, mjedisit dhe njerëzimit.

Zgjedhja e vendit të çmimit i referohet 9 marsit të kaluar 2021, ku u përrua statuja e poetit ukrainas Taras Shevchenko (1814-1861), e punuar në bronz nga artisti ukrainas Oleg Pinchuk, së bashku me ekipin e tij – Sheludko Volodymyr dhe Artem Tomashevsky. Vepra iu dhurua nga qyteti i Kievit Bashkisë së Firences për të përkujtuar binjakëzimin historik që lidh dy qytetet që nga viti 1967 dhe si falënderim për monumentin e Dante Alighieri-t të instaluar në qendrën historike të Kievit më 10 dhjetor 2015.

Çmime morën personat e



mëposhtëm:

Francesco Corsi, si kuratori më i mirë i artit i vitit 2021

Florentini me origjinë, ish-profesor i filozofisë, botues dhe themelues i kompanisë së artit ARTinGENIO, qershorin e kaluar inauguroi “ARTinGENIO MUSEUM”, Muzeu i artit bashkëkohor në dialog me botën mesjetare, i ndërtuar në Pizë në strukturën prestigjioze dhe moderne të punishteve të Garibaldit.

Alfred Milot Mirashi – jeton dhe punon në Firençe, artisti italo-shqiptar shquhet mbi të gjitha për veprat e tij të jashtëzakon-

shme të skulpturave monumentale. Së fundmi ai është duke realizuar në Avellino “Çelësi i Montevergines” një veper gati 50 metra. Një nga skulpturat më të mëdha në Evropë të bëra prej çeliku Corten. Me instalacionet e tij artisti i dërgon një mesazh mbarë botës: “Nuk duhet t’i mbajmë dyert mbyllura te gjithë duhet të kenë mundësinë të realizojnë ëndrrat e tyre”. Çelësat e tij si instalacione mund të quhen “Çelësi i Bashkimit” me një mesazh ku shpresa për dialog te hapur drejt një zhvillimi me paqe mes popujve.

Maryna Shavrova – ukrainase nga lindja, fiorentine nga birësimi, do të marrë çmimin si promovuese e kulturës dhe artit ukrainas në Itali.

EKA, muzikanti dhe kompozitori ukrainas, i cili ka jeton në Itali prej vitesh, do të luajë *Bandar*, një instrument i lashtë me 64 tela. Edhe ajo mori çmimin si bandoristja më e mirë e vitit 2021 direkt në skenën e Kievit.

Ceremonia e ndarjes së çmimeve u zhvillua nën patronazhin e Konsullatës së Ukrainës në Firençe me përfaqësuesen e saj Oxana Polataitchouk.

Fitues e ketij edicionit në Qytetin e Kievit në Ukrainë Oleg Pinchuk- artisti i vitit

Alfred Milot Mirashi – Skulptori i vitit

Francesco Corsi- Kuratori i vitit

Valeria Leschova – kuratrice e artit bashkëkohor

EKA – bandurista e vitit

Maryna Shavrova- promovuese e artit dhe kulturës ukrainase në Itali

Kamaliya – këngëtarja e vitit

Igor Mizrahk – personaliteti i vitit

Elmira Akhundova – diplomatja e vitit

(ajo është ambasadore, deputete dhe shkrimtare e Azerbajxhanit)

Elena Leticia Teresa Mikusinski – diplomatja e vitit

(Amasadore della Argentina a Kiev)./KultPlus.com



EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Enveri
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
 TEL: 045/82 82 82

Balkani mposhti në derbi Prishtinën, Drenica nuk gabon ndaj Dukagjinit

PRISHTINË, 24 TETOR - Skuadra e Ballkanit vazhdon të kryesojë në renditjen e BKT Superligës së Kosovës në futboll edhe pas javës së 12-të. Skuadra portokallezi nga Suhareka ka shënuar fitore para tifozëve të vet ndaj skuadrës kampione në fuqi, Prishtinës, me rezultat 2-0, duke e ruajtur pozitën e parë në renditje, me 21 pikë, një më shumë se dy ndjekësit më të afërt, Drenica dhe Gjilani. Pjesa e parë ishte e barabartë si me lojë ashtu edhe me rezultat, ndonëse Prishtina nga minuta e 30-të luajti me një lojtar më pak, pas përjashtimit të Makendas me karton të kuq pas dy të verdhëve. Përparësinë numerike në fushë vendasit e shfrytëzuan maksimalisht në pjesën e dytë, kur arritën të shënojnë dy herë. Rezultatit e zhbllkoi Theophilus Solomon

në minutën e 58-të, kur realizoi me kokë pas harkimit të Ermal Krasniqit. Ndërkaq, ky i fundit e vendosi rezultatit përfundimtar me një gol të bukur nga distanca. Fitore në shtëpi dhe me të njëjtin rezultat (2-0) shënoi edhe Drenica në duel me Dukagjinin. Të dyja golat për kuqezinjët e Skenderajt i realizoi braziliani Dennison, të parin nga penalltia në minutën e 36, të dytin në minutën e 70. Pas kësaj fitoreje, Drenica ruan pozitën e dytë me 20 pikë aq sa ka edhe Gjilani në pozitën e tretë, derisa Dukagjini renditet në pozitën e 8 me 10 pikë. Të shtunën janë zhvilluar tri ndeshje. Gjilani ka shënuar fitoren e radhës në shtëpi, duke e mundur Feronikelin me rezultat të ngushtë 1-0. Golin e vetëm të kësaj përballjeje e ka shënuar Blerim Krasniqi me



gjuajtje me kokë në minutën e 64-t. Ndërkaq në dy ndeshjet e tjera fitoreve iu gëzuan skuadrat mysafire. Drita arriti ta mposhtë Llapin në Merdar me rezultat 3-1. Astrit Fazliu e hapi serinë e golave në minutën e 4-t nga penalltia. Epërsinë në 2-0 e shtoi ish-futbollisti i llapjanëve, Hamdi Namani, në minutën e 34-t.

Llapi arriti ta ngushtojë diferencën në minutën e 47 me golin e Alban Shillovës nga pika e bardhë, por fitoren e gjilanasve e vulosi Marko Simonovski me golin e shënuar në minutën e 72-të. Tri pikë të rëndësishme në udhëtim i arkëtoi edhe Ulpiana, që e mundi Malishevën me shifrat 2-1.

Santos (16') dhe Ardi Shala (52') realizuan golat e fitores së Ulpianës, kurse golin e ngushëllimit për malishevasit e shënoi Olluri.

BKT Superliga	
Ballkani - Prishtina	2-0
Drenica - Dukagjini	2-0
Gjilani - Feronikeli	1-0
Malisheva - Ulpiana	1-2
Llapi - Drita	1-3

Tabela	
	Pikë
1. Ballkani	21
2. Drenica	20
3. Gjilani	20
4. Drita	19
5. Prishtina	13
6. Malisheva	12
7. Llapi	12
8. Dukagjini	10
9. Ulpiana	10
10. Feronikeli	10



Ekipi i boksit të Kosovës nuk lejohet as herën e tretë të hyjë në Serbi

PRISHTINË, 24 TETOR - Delegacioni i boksit të Kosovës nuk është lejuar të hyjë në Serbi as të dielën, në tentimin e tyre të tretë, për të marrë pjesë në Kampionatin Botëror të boksit amator. Lajmi është bërë me dije nga zëdhënësi i Komitetit Olimpik të Kosovës, Kushtrim Krasniqi. Të

shtunën ekipi i boksit u ndalua dy herë të kalonte kufirin me Serbinë. Fillimisht u ndalua dhe iu kërkua t'i linte tutat sportive ku kishte simbole të shtetit të Kosovës. Delegacioni i Kosovës nuk pranoi, teksa kjo alarmoi edhe AIBA-n, që kërkoi nga Serbia ta trajtonte Kosovën si të

gjitha vendet e tjera pjesëmarrëse. Ekipi i Kosovës provoi edhe një herë të shtunën në mbrëmje, pa simbolet e shtetit të Kosovës, por sërish nuk u lejua. Kujtojmë se botërori filloi të dielën, ndërsa Kosova synonte të merrte pjesë me tre boksierë.



Ferizaj e humbi edhe ndeshjen e dytë në Holandë

FERIZAJ, 24 TETOR - Skuadra e Ferizajt e ka humbur edhe ndeshjen e dytë nga skuadra holandeze JuRo Unirek. Të dielën në Veld të Holandës, Unireku fitoi me rezultat 37-13. Të shtunën skuadra holandeze fitoi 35-14. Me dy fitore, JuRo Unirek avancon në raundin e

tretë të Kupës Evropiane. Ndërkohë Ferizaj ndalet në raundin e dytë, njëjtë si Vushtrria, Istogu e Prishtina. Pas pjesës së parë rezultati ishte 17-7 për holandezet. Meri Koneski ishte më efikasja te Ferizaj. Ajo shënoi 7 gola nga 17 tentime. Dy gola i shënoi

Mirjeta Dinolli, ndërsa nga një e shënuan Iva Stojkovska, Mimoza Sefedini, Albulena Kelmendi e Bjondina Ramabaja. Tani skuadrat e hendbollisteve u kthehen sfidave vendore. Pritet garë e mirë për titull të kampionit dhe për Kupën e Kosovës.

'El Clasico' i takon Realit

MADRID, 24 TETOR - "El Clasico" e parë e këtij sezoni fitohet nga Real Madridi. Skuadra e Carlo Ancelottit arriti një sukses shumë të rëndësishëm 2-1 në fushën e "Camp Nou". Në 30 minutat e para loja ishte e

ekuilibruar me të dyja ekipet që u kujdesën për ta studiuar njëra-tjetrën. Në minutën e 32-të, pas një kundërsulmi të shpejtë, David Alaba lëshon një të majtë të hidhur në cepin e portës së Ter Stegen, duke mos i dhënë

asnjë mundësi reagimi. Barcelona kërkoi të reagoje, por Reali në anën tjetër kundërsulmonte shumë rrezikshëm. Në fundin e ndeshjes, del mjaft shpejt, ndalet nga Ter Stegen, por më pas

Lucas Vazquez e ka të thjeshtë për ta shoqëruar në rrjetë. Në fundin e ndeshjes Agüero rihapi ndeshjen, por nuk kishte më kohë për një tjetër gol. Reali merr kryesimin me 20 pikë, po aq sa Sevilla dhe Real Sociedad.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

